

**A K T   T H E M E L I M I**  
**I SHOQËRISË "RENT ME" shpk**

Kjo shoqëri themelohet me vullnetin e ortakëve në përputhje me ligjin nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe dispozitat e Kodit Civil në pjesën që rregullojnë personat juridikë.

Neni 1

**QËLLIMI**

Ortakët bien dakort të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar për të zhvilluar veprimtari tregtare kryesisht në fushën tregimit dhe qiradhënisë së mjeteve motorike si edhe cdo veprimtari që lejohet nga ligji për formën juridike të shoqërisë.

Shoqeria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga statuti dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 2

**EMRI**

Shoqëria ka emrin e saj: "**RENT ME**" shpk

Neni 3

**SELIA**

Selia është në Shqipëri, Durrës, Autostrada DR-TR, Km. 6, Xhafzotaj, pranë Autosallonit të Mektrin Motors.

Selia e shoqërisë mund të transferohet me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

**AFATI**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar.

Ky afat mund të ndryshohet me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Ortakeve.

Neni 5

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

(i) tregtimi dhe qiradhënia e mjeteve motorike si edhe cdo veprimtari që lejohet nga ligji për formën juridike të shoqërisë

Neni 6

#### ADMINISTRIMI

Administrator është personi fizik i cili gjëzon kompetencat e parashikuara në Ligjin Tregtar dhe emërohet për një afat **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje. Shoqëria mund të ketë më shumë një administratorë, të cilët janë :

1. **Ideal Shala**, biri i Avdi, i lindur më 16.01.1979, në Prishtinë, banues në rr. Dëshmorët e Konushevcit pn, Prishtinë, mbajtës i dokumentit personal 1001077356.
2. **Edmond Shahini**, i biri i Skënder, i lindur më 21.04.1975, banues në Durrës, Kodër Vilë, P. 1, H. 0, mbajtës i dokumentit personal H50421170A.

Neni 7

#### ORTAKËT THEMELUES

Ortakët themelues të shoqërisë janë:

1. **Edmond Shahini**, biri i Skënder, dtl. 21.04.1975, banues në Shqipëri, Durrës, Kodër Vilë, P. 1, H. 0, mbajtës i dokumentit personal H50421170A
2. **Ideal Shala**, biri i Avdi, dtl 16.01.1979, në Prishtinë, banues në Kosovë, Prishtinë, rr. Dëshmorët e Konushevcit pn, mbajtës i dokumentit personal 1001077356.
3. **Artion Beqiraj**, biri i Zihni, dtl. 24.01.1980, banues në Shqipëri, Durrës, L. 18, Rr. Kristo Sotiri, P. Jashari, Ap. 3, K. 3, mbajtës i dokumentit letërnjoftim nr. 034894103

Neni 8

#### KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përcaktuar 100,000.00 (njëqind mijë) euro e konvertuar me monedhën lekë në vlerë 12,000,000.00 (dymbëdhjetë milionë) lekë , sipas marrëveshjes mes ortakëve, që ndahet në kontributet e Ortakëve themelues, si vijon:

1. **Edmond Shahini** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 51% në kapital me vlerë 6,120,000.00 lekë.
2. **Ideal Shala** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 40% në kapital me vlerë 4,800,000.00 lekë.
3. **Artion Beqiraj** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 9% në kapital me vlerë 1,080,000.00 lekë

Kapitali fillestare dhe kontributet që përbëjnë atë akordohen në Para (lekë).

Vlera e kapitalit të nënshkruar do të derdhet nga secili prej ortakëve e ndarë në këste, brenda afatit që përcaktohet nga statuti dhe asambleja e ortakëve të shoqërisë.

Vlera tjeter e kapitalit do të investohet në kuadër të shoqërisë pas krijimit të saj, në bazë të planifikimit të biznesit që miratohet me pëlqimin e ortakëve.

Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës të kapitalit së nënshkruar.

Neni 9

#### KUFIZIMET


Cdo ortak nuk ka të drejtë të zotërojë direk ose indirekt kompani në pronësinë e tij apo të familjarëve të tij, që ndërlidhet direkt apo indirekt me dhënien e veturave me qera apo Operational Leasing kudo që operon Sixt Se franchising, jashtë kësaj marrëveshje.

### ORTAKËT

Edmond Shahini



Ideal Shala



Artion Beqiraj



Datë: 04/08/2022

### STATUTI

#### I SHOQËRISË “RENT ME” shpk

Ky Statut hartohet në përputhje me vullnetin e ortakëve dhe bazuar në ligjin nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

Neni 1

FORMA

Shoqëria është person juridik i formës shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, me akronimin SHPK.

Neni 2

EMRI - EMËRTIMI

Shoqëria ka emrin e saj: “RENT ME” shpk

Emërtimi tregtar i shoqërisë është: RENT ME

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë:

- (i) tregtimi dhe qiradhënia e mjeteve motorike si edhe cdo veprimtari që lejohet nga ligji për formën juridike të shoqërisë

Neni 4

SELIA

Selia është në Shqipëri, Durrës, Autostrada DR-TR, Km. 6, Xhafzotaj, pranë Autosallonit të Mektrin Motors.

Neni 5

AFATI

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin me afat të pakufizuar.

Neni 6

ORTAKËT DHE KAPITALI THEMELTAR

Ortakët e shoqërisë janë:

1. **Edmond Shahini**, biri i Skënder, dtl. 21.04.1975, banues në Durrës, Kodër Vilë, P. 1, H. 0, mbajtës i dokumentit ID personal H50421170A
2. **Ideal Shala**, biri i Avdi, i lindur më 16.01.1979, në Prishtinë, banues në rr. Dëshmorët e Konushevçit pn, Prishtinë, mbajtës i dokumentit personal 1001077356.
3. **Artion Beqiraj**, biri i Zihni, dtl. 24.01.1980, banues në Shqipëri, Durrës, L. 18, Rr. Kristo Sotiri, P. Jashari, Ap. 3, K. 3, mbajtës i dokumentit letërnjoftim nr. 034894103

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përcaktuar 100,000.00 (njëqind mijë) euro e konvertuar me monedhën lekë në vlerë 12,000,000.00 (dymbëdhjetë milionë) lekë , sipas marrëveshjes mes ortakëve, që ndahet në kontributet e Ortakëve themelues, si vijon:

1. **Edmond Shahini** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 51% në kapital me vlerë 6,120,000.00 lekë.
2. **Ideal Shala** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 40% në kapital me vlerë 4,800,000.00 lekë.
3. **Artion Beqiraj** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 9% në kapital me vlerë 1,080,000.00 lekë

Fondet e kapitalit të nënshkruar nga ortakët do të depozitohen në Bankë të ndarë në këste, nga secili prej ortakëve në këtë mënyrë:

Brenda 10 ditëve kalendarike nga regjistrimi i shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit secili ortak do të shlyej në bankë nga vlera përkatëse e kontributit të nënshkruar. Konkretnisht:

- a) **Edmond Shahini** brenda afatit më sipër duhet të shlyejë shumën 25,500.00 euro
- b) **Ideal Shala** brenda afatit më sipër duhet të shlyejë shumën 20,000.00 euro

c) **Artion Beqiraj** brenda afatit më sipër duhet të shlyejë shumën 4,500.00 euro

Shlyerja do të konsiderohet e rregullt kur vlera përkatëse të kreditohet në llogarinë bankare të shoqërisë.

Vlera tjetër e kapitalit do të investohet në kuadër të shoqërisë pas krijimit të saj, në bazë të planifikimit të biznesit që miratohet me pëlqimin e ortakëve.

Neni 7

#### PJESËT E KAPITALIT

Kapitali themeltar i shoqërisë ndahet në kontributet e Ortakëve si vijon:

1. **Edmond Shahini** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 51% në kapital me vlerë 6,120,000.00 lekë.

2. **Ideal Shala** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 40% në kapital me vlerë 4,800,000.00 lekë.

3. **Artion Beqiraj** zotëron 1 kuotë, me pjesëmarrje 9% në kapital me vlerë 1,080,000.00 lekë

Kur pjesët e kapitalit zotërohen nga një person i vetëm (fizik ose juridik), shoqëria tregtare vijon të funksionojë si shoqëri me ortak të vetëm, fakt ky që duhet regjistruar në regjistrin tregtar.

Neni 8

#### KONTRIBUTET

Kapitali fillestar dhe kontributet që përbëjnë atë akordohen në Para (lekë).

Neni 9

#### PËRGJEGJËSIA

Ortakët përgjigjen ndaj të tretëve për detyrimet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të nënshkruar. Çdo marrëveshje, në kundërshtim me këtë dispozitë, nuk prodhon efekte ndaj palëve të treta.

Në raport me detyrimet ndërmjet ortakëve, ortaku huamarrës/debitor përgjigjet me pasuritë personale për detyrimet që ka ndaj ortakut kreditor.

Neni 10

#### LËVIZJET E KAPITALIT

Në vijim të veprimtarisë kapitali i shoqërisë mund të jetë objekt ndryshimi në përputhje me interesat ekonomike dhe tregtare të shoqërisë.

Me pëlqimin unanim të ortakëve lidhur me natyrën e aktivitetit tregtar, markën e përfaqësimit, bihet dakort që kapitali i shoqërisë të zmadhohet në të ardhmen sipas plan biznesit dhe ndryshimeve.

Zmadhimi i kapitalit do të bëhet me pëlqimin unanimin të ortakëve. Asnjëri ortak nuk mund të zmadhojë kapitalin, pa pëlqimin paraprak të ortakut tjetër.

Ortaku/ët mund të bëjnë zmadhimin e kapitalit me kontribut në rastet kur dakordohen që njëri ortak të bëjë zmadhimin edhe për ortakun/ët e tjerë brenda nivelistë % së pjesëmarrjes në kapital. Ortaku/ët e tjerë detyrohen t'ia kthejnë vlerën e investuar në zmadhim, me kamatë, norma e interesit do të

përcaktohet duke marrë për bazë normën e financimit të kredisë për shoqerinë nga banka, ose mesataren e kamatës së tri bankave në Republikën e Shqipërisë në rastet kur shoqeria nuk është financuar me kredi.

Ortaku/ët huamarrës do të shlyejnë detyrimet rregullisht sipas afatit të miratuar mes tyre, në rast të kundërt detyrimet do të mbulohen me të ardhurat që atij i takojnë nga shoqeria deri në momentin e shlyerjes së obligimeve në favor të ortakut huadhënës.

Ortakët që nënshkruajnë zmadhimin duhet të shlyejnë kontributin brenda afateve të caktuara në vendimin e Asamblesë. Kontributet e reja pasqyrohen në pjesët takuese të secilit ortak.

#### Neni 11

##### KUOTA, KALIMI I TYRE

Kuota është lirisht e transferueshme ndërmjet ortakëve në raport me pjesët e secilit.

Ortaku nuk mund të transferojë kuotën jashtë rrethit të ortakëve pa respektuar të drejtën e parablerjes së ortakëve ekzistues. Parablerja mund të ushtrohet në proporcion me pjesën që cdo ortak mban, brenda 60 ditëve me afat dekadence, nga data e marrjes dijeni të njoftimit.

Për këtë qëllim ortaku duhet të njoftojë ortakët dhe organin administrativ me njoftimin elektronik në adresën e regjistruar, ku të shënohen gjeneralitetet e blerësit, çmimi i kërkuar ose vlera e kuotës, mënyra e pagesës si edhe kushtet e vecanta të shitjes.

Organi administrativ kujdeset të njoftojë pa vonesë dhe në cdo rast brenda 5 ditëve kalendarike ortakët për njoftimin dhe të drejtën për ushtrimin e parablerjes.

Parablerja nuk mund të bëhet pa miratimin dhe pëlqimin e dy ortakëve.

Çdo transferim në kundërshtim me pikat e mësipërme do të konsiderohet i pavlefshëm..

#### Neni 12

##### MARRËDHENIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

Ortakët gjëojnë të drejtën e térheqjes së fitimit të realizuar në raport me pjesën e zotëruar në kapital dhe shpërndarja e fitimit bëhet në respektim të kërkesave ligjore ne fuqi.

Shoqeria ruan të drejtën të anulojë kuotën e zotëruar nga ortaku. Si shkaqe dhe procedura të anulimit do të zbatohen rastet e parashikuara në ligj, statut ose që shoqeria do të vendosë me vendim të posaçëm.

#### Neni 13

##### ORGANET E SHOQËRISË

Asambleja e Ortakëve është organi përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi cështjet themelore siç përcaktohet në nenin 81 të Ligjit Tregtar nr. 9901/2008.

Administratorët janë organe ekzekutive dhe menaxheriale të shoqërisë.

Asambleja mund të thirret ose nëpërmjet njoftimit me shkrim (dorazi, rekomande) ose nëpërmjet postës elektronike e-mail. Për thirrjet me postë elektronike adresa e vlefshme e çdo ortaku është ajo që regjistrohet në regjistrin e shoqërisë me shënimin e nënshkrimit nga Ortakët.

Njoftimi dërgohet jo më vonë se 7 ditë përpëra datës se parashikuar për mbledhjen. Njoftimi përbën vendin, datën, orën dhe rendin e ditës.

Vendimet e marra në kundërshtim me përcaktimin e rregullave të thirrjes janë të pavlefshme, përvèç nëse ortaket shprehen unanimisht dakort pavarësisht parregullsisë.

Parimiشت mbledhjet organizohen në Selinë e Shoqërisë, por kur ekzitojnë arsy objektive mund të mbahen në një vend tjeter të caktuar nga thirrësi.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet apo/dhe vendimet e asamblesë personalisht ose i përfaqësuar nga një ortak tjeter ose një person i tretë i zgjedhur prej tij.

Autorizimi mund të lëshohet vetëm për një mbledhje ose disa të tillë me kushtin që të konsiderohen mbledhje vazhduese me të njëtin rend dite.

Mbledhjet mund të organizohen dhe mbahen pa prezencën fizike të ortakëve ose përfaqësuesve nëpërmjet platformave online me videokonferencë, me kushtin që të konfirmohet identiteti i ortakut dhe votimi i tij. Nuk mund të refuzohet kërkesa për mbajtjen e mbledhjes online kur ajo paraqitet të pëktën 3 ditë përpëra datës së mbledhjes. Administratori siguron ndërlidhjen dhe organizimin e mbledhjes.

#### Neni 14

#### VENDIMMARRJA

Çdo kuotë jep të drejtë e një vote e cila llogaritet në bazë të pjesës takuese në kapital. Vendimet konsiderohen të vlefshme kur në mbledhjen e asamblesë marrin pjesë (fizikisht ose virtualisht) dhe votojnë "pro" ortakët me të drejtë vote sipas përcaktimeve të kuorumit të parashikuar në statut.

Vendimet e asamblesë regjistrohen dhe protokollohen në Regjistrin përkatës të shoqërisë dhe procedura përkatese ndiqet nën përgjegjësinë e Administratorëve.

Autorizimet lidhur me térheqjen e vlerave Cash nga shoqëria dhe ndryshimet ne Statut mund të bëhen vetëm me pëlqimin unanim te ortakëve.

#### Neni 15

#### ADMINISTRATORI

Administrator është personi fizik i cili gjëzon kompetencat e parashikuara në Ligjin Tregtar dhe emërohet për një afat **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria mund të ketë një ose më shumë administratorë të cilat janë :

1. **Ideal Shala**, biri i Avdi, i lindur më 16.01.1979, në Prishtinë, banues në rr. Dëshmorët e Konushevcit pn, Prishtinë, mbajtës i dokumentit personal 1001077356.
2. **Edmond Shahini**, i biri i Skënder, dtl. 21.04.1975, banues në Durrës, Kodër Vilë, P. 1, H. 0, mbajtës i dokumentit ID personal H50421170A

Kompetencat e Administratorëve ushtrohen veç e veç:

**Ideal Shala** është administrator operacional i shoqërisë. Ai kryen veprimet operacionale të lidhura me kontratën franchising me kompaninë Sixt Se të shoqërisë.

**Edmond Shahini** është administrator i përgjithshëm i shoqërisë. Ai kryen veprimet e administrimit ligjor që bien jashtë aktivitetit operacional.

- Cdo veprim administrimi do të kryhet nëse është në interesin më të mirë të shoqërisë dhe me transparencë të plotë.

- Lidhja e kontratave/marrëveshjeve/detyrimeve (aktet), ndryshimet ose zgjidhja e tyre miratohen me vendim unanim të ortakëve. Ato miratohen si draft model nga asambleja dhe janë të shoqëruara me vendimin e asamblesë i cili një kopje regjistrohet në regjistrat e shoqërisë. Asambleja autorizon njërin nga administratorët brenda fushës së kompetencave, të kryejë veprimet e përfaqësimit për formalitet përkatëse vijuese lidhur me aktin.

- Faturat që përmbajnë vlera për shërbime, mallra, detyrime të cdo lloji me vlerë më të lartë se 4,900.00 (katërmijë e nëntëqind) euro (ose ekuivalenca në monedhë tjetër) për cdo furnitor do të miratohen unanimisht nga asambleja e ortakëve.

- Publikimi i kompetencave të Administratorëve përbën njohje të mjaftueshme nga të tretët. Në cdo rast, akti/et detyrimet e lidhura në kundërshtim me këtë dispozitë janë të pavlefshëm për shoqërinë dhe përgjegjësia drejtohet automatikisht tek ortaku/administratori që ka vepruar në shkelje të këtij parimi, i cili në raport me shoqërinë konsiderohet se ka thyer parimin e besimit.

- Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës franchising nga Sixt për arye që i ngarkohen kuadrit operacional Administratori operacional do të jetë personalisht përgjegjës në përmbushjen e detyrimeve rrjedhëse.

#### Neni 16

#### LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Çdo ortak mund të largohet nga shoqëria duke njofuar 6 muaj përpara me shkrim shoqërinë ku duhet të jenë përmendur shkaqet e largimit. Ortaku gjëzon të drejtat që njeh ligji kur shkaqet e largimit janë të arsyeshme, në të kundërt ai detyrohet të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet eventuale të shkaktuara.

Largimi dhe përjashtimi i ortakëve mund të bëhet vetëm dhe trajtohet në pajtim me dispozitat ligjore, ashtu siç i parasheh Ligji nr.9901 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 17

#### VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË

Çdo vit finansiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të atij viti.

Llogaritë vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit finansiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratorët miratohen nga Asambleja. Miratimi i llogarive mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.

Neni 18

DIVIDENTËT

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e Ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividentit mbi fitimin.

Shpërndarja e fitimeve bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 19

BASHKIMI, NDARJA,

Shoqëria me vendimin e Asamblesë së Ortakëve mund të vendosi bashkimin apo ndarjen e shoqërisë.

Modalitet për realizimin e këtij veprimi përcaktohen rast pas rasti me vendim.

Neni 20

LIKUIDIMI

Shoqëria hyn në procedurën e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj reportin mbi gjëndjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në mungesë të organeve, aplikohen dispozitat ligjore lidhur me likuidimin.

Neni 21

SHNDËRRIMI I SHOQËRISË

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

Neni 22

LEGJISLACIONI / MOSMARRËVESHJET


Legjislacioni i zbatueshëm është ai i vendit të regjistrimit të shoqërisë.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se dështon zgjidhja me mirëkuptim, palët do të vijojnë me juridikcion arbitrazhi sipas dispozitave ligjore në fuqi për gjykimin me forum arbitrazhi duke zbatuar rregullat e arbitrazhit ICC që janë në fuqi. Secili ortak ka të drejtë të zgjedhë arbitrin si dhe me pëlqimin e të gjithë ortakëve caktohen aq arbitra sa formohet forum me numër tek arbitrash. Ortaku që nuk ushtron të drejtën e caktimit të arbitrit brenda një muaji nga nisja e procedurës së caktimit humbet të drejtën për caktim. I njëti rregull zbatohet në rastin e ndryshimit të arbitrit. Ortaku nuk mund të ndryshojë arbitrin, përvèc rasteve kur ai vdes ose bëhet i paaftë.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Shqipëri, përvèc rastit kur ortakët bien dakort që e gjithë procedura ose pjesë nga arbitrazhi të zhvillohen në një vend tjetër.

**ORTAKËT**


Edmond Shahini




Ideal Shala



Artion Beqiraj



Datë: 04/03/2022



Qendra Kombetare e Biznesit  
National Business Center (/)

(/) (/home/)

Kërkon



Menu

## Kontrollo statusin e aplikimit për regjistrim

Emri i aplikantit

CN-949859-07-22

Kërko

Pastro

Numri i cështjes	Nipti	Aplikanti	Shërbimi	Gjendja e cështjes	Data	Arsyeja e cështjes
CN-949859-07-22	-	Artion Beqiraj	Name Reservation	Approved	13.07.2022	

Faqe 1 nga 1

1



© 2022 QKB ALL RIGHTS RESERVED

(<https://www.facebook.com/QKB-Qendra-Komb%C3%ABtare-e-Biznesit-970340259660116/>)

(<https://twitter.com/qkb2016>)